




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 494/ Prot  
Dt. 10.02.23



Nr. 118/1 Prot.

Shkodër, më 10.02.2023

Lënda: Mbi Vendimin nr. 6, datë 25.01.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.



**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 54, shkronja "e/1", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të VKM nr. 68, datë 31.03.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të palujtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës", të ndryshuar, të VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qera, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, të Udhëzimit nr. 13, datë 18.04.2018 "Për zbatim të VKM nr. 54, datë 5.02.2014", të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 491 prot., datë 30.01.2023 dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, shqyrtoi **VKB nr. 6, datë 25.01.2023** "Mbi dhënien në përdorim më anë të konkurrimit publik me afat deri në 10 vjet të sipërfaqes prej 7545 m<sup>2</sup>, pjesë e pasurisë Nr. 546/4, ZK 3606, e llojit pa fryt, me qëllim përdorimi për ushtrim aktiviteti në fushën e bujqësisë, të blegtorisë, agropërpunimit në fshatin Stajkë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës".

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon procedimin  
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T**

**Majlinda ANGONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr 06 Datë 25.012023

**Rishqyrtim i Vendimit nr 38, datë 28.06.2021, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet të sipërfaqes prej 7545 m2, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, e llojit “Pa fryt” në fshatin Stajkë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës.**

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1”(ndryshuar), neni 55 pika 3, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vërtetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8744 datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, në VKM nr 246 dt 31.03.2011. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin 68, dt 31.03.2011, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, VKM nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, në Udhëzimin nr 13, datë 18.04.2018, “Për zbatimin e Vendimit të Ministrave nr 54 dt 05.02.2014,”Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, në çertifikatën e pronësisë për pasurinë nr 546/4, lëshuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, si dhe pas shqyrtimit të Projekt Vendimit nr 3, datë 13.01.2023, paraqitur nga Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritimit, ku kërkohet Rishqyrtimi i VKB nr 38, datë 28.06.2021 “Për miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 7545 m2, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, e llojit “Pa fryt” në fshatin Stajkë, NJAD Bushat, pronë e Bashkisë Vau Dejës”, pas shqyrtimit, diskutimit dhe miratimit, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI

1. Miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurimit, me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 7545 m2, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, e llojit “Pa fryt”, ndodhur në fshatin Stajkë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës, plotesimin e dokumentacionit e VKB-së Vau Dejës nr 38, datë 28.06.2021, duke shtuar çertifikatën e pronësisë për pasurinë nr 546/4, Zk nr 3506.



2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritimit.
3. Pas shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut, do vazhdohet me procedurat e konkurimit, shpalljen në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe më pas me hapat e mëtejshëm të procedurës, me të gjithë elementet përbërës të saj deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR**

Mark Bisha

Sekretari Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija

Miratuar me 19

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 26.01.2023

